



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:272693 C. nr. 4772/2023
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06184730

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.A. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 19 shtator 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. MIRATOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.A. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 25 muaj (për çdo muaj shumë prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë - 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t’ia paguajë shumë e përgjithshme prej 1,383.75 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 06.12.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET e paditura, që paditëses, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja S.A. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj A.H. avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datën 06.12.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, vlera e kontestit 1,383.75 euro.

Në referatin e padisë, pala paditëse ka theksuar se paditësja punon pranë Shkollës SHFMU "Mustafa Baku" në Prizren dhe është i licencuar dhe kualifikuar mësimdhënës me titull Baçellor fakultetin e Edukimit – programi fillor Baçellor i Programit Parashkollor. Meqenëse paditësja është i licencuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit në nivelin bachelor me diplomë fakulteti, në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008,

përkatësisht nenit 3 të këtij vendimi, të njëjtit i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 27% të pagës bazë, çka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht. Paditësi realizon pagën bazë prej 421.00 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 113.67 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 58.32 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 55.35 euro, që nga data 01.01.2022 deri në 31.01.2023, për gjithsej 25 muaj në shumën prej 1,383.75 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e palës paditëse se i takon kompensimi deri me datë 31.12.2022, janë të pa bazuara për arsye se sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023, të datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga KKA, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar. E njëjta ka theksuar se pretendimet e paditësit se iu takon kompensimi i shujtave ditore është në kundërshtim me nenin 2 par.1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, pasi përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtar të sindikatës. Të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësve është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të papazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja S.A. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHFMU “Mustafa Baku” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të paguar.

Nga kontrata e punës nr.247/2020 të datës 09.10.2020 e lidhur ndërmjet paditëses S.A. dhe të paditurës, rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënës, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjti ka të përfunduar fakultetin e Edukimit dhe e njëjta ka marrë titullin Bachelor i Programit Fillor, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 478, e datës 03 nëntor 2016, e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit-Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses. Nga vërtetimi me numër të protokollit 322/2023 i datës 13.11.2023, vërtetohet se paditësja S.A. është në marrëdhënie pune në

SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren, nga data 09.10.2020, dhe e njëjta vazhdon të punojë si mësimdhënëse pran kësaj shkolle. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar paditëses shumën prej 58.32 euro në muaj.

Mirëpo, duke marrë parasysh që kërkesa e paditëses është parashtruar lidhur me pagën bazë në lartësi prej 421.00 euro, gjykata vendosi që paditëses i takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 421.00 euro apo në shumë prej 55.35 euro. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro, për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 25 muaj, shumën e përgjithshme prej 1,383.75 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 55.35 euro, duke e shumëzuar për 25 muaj ($25 \times 55.35 = 1,383.75$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së,

duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 06.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 4772/2023 të datës 19 shtator 2024

B. Profesional,
Ilir Sërtollaj

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.